



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.117/6 prot.

Tiranë më 14.02.2025

U R D H Ë R

Nr. 27, datë 14.02.2025

PËR KONTROLLUESIN GJIMNAZI “BESNIK SYKJA”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar (në vijim “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim “*Kodi i Procedurave Administrative*”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Gjimnazi “Besnik Sykja” (në vijim, “*Kontrolluesi*”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 09, datë 14.01.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit, me objekt:

- *Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.*

Zyra e Komisionerit pasi shqyrtoi procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ pranë Kontrolluesit, ka konstatuar se:

1. Kontrolluesi, ushtron aktivitetin si institucion arsimor publik parauniversitar në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë Kontrolluesi mbledh dhe përpunon ndër të tjera, të dhëna personale për kategorinë “nxënës”.

2. Zyra e Komisionerit, ka administruar ankesën me nr. 2539 prot., datë 03.12.2024 përmes të cilës përfaqësuesja ligjore e znj. _____, pretendon se në dokumentin shkollor “Vërtetim”, me nr. 417, datë 17.07.2024, nuk janë pasqyruar saktë të dhënat personale të znj. _____ sipas certifikatës personale, gabim i cili konsiston në pasqyrimin e pasaktë të atësisë dhe mbiemrit të saj, përkatësisht nga i sakti “_____” në të pasaktë “_____”.
3. Referuar ankesës, Zyra e Komisionerit i është drejtuar Kontrolluesit më shkresën nr. 2539/1 prot., datë 11.12.2024 “Kërkesë për informacion në kuadër të trajtimit të një ankese”, duke i bërë me dije detyrimet që rrjedhin nga neni 13 dhe 19 të Ligjit, në të cilën parashikohet e drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit të kërkojë nga Kontrolluesi bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij/saj nuk janë të rregullta, të vërteta ose të plota.

Në përgjigje të kërkesës së Zyrës së Komisionerit, Kontrolluesi, me shkresën nr. 126 prot., datë 15.01.2024, administruar me tonën me nr. 117/2 prot., datë 20.01.2025, ka shprehur dakordësinë, në lidhje me pasaktësinë e gjeneraliteteve të pasqyruara në Amzë, gabim i cili konsiston në pasqyrimin e pasaktë të atësisë dhe mbiemrit të saj, ndryshe nga sa rezulton në certifikatën e lindjes, por nuk ka marrë masa për korrigjimin e të dhënave.

4. Në vijim, në zbatim të Urdhrit nr. 09, datë 14.01.2025 të Komisionerit, u krye hetimi administrativ nga grupi i inspektimit, i cili u paraqit pranë ambienteve të kontrolluesit për të kryer verifikimet përkatëse lidhur me ankesën.

Nga provat e administruara në dosje, rezulton se Kontrolluesi disponon 2 regjistra: Regjistri i veçantë dhe Amza. Në Amzë, të dhënat e ankueses janë pasqyruar gabim, gabim i cili konsiston në pasqyrimin e pasaktë të atësisë dhe mbiemrit të saj, përkatësisht nga i sakti “_____” në të pasaktë “_____”, ndërsa në Regjistrin e veçantë është regjistruar si “_____”.

Nga sa më sipër, konstatohet se, edhe pse është faktuar nga ana e ankueses mbi bazë aktesh shkresore si: Certifikata e lindjes dt. 24.10.2024 dhe vërtetimi nr. 2172/1 prot., datë 11.11.2024 i Zyrës së Gjendjes Civile, nga ku rezulton se figuron vetëm një shtetase e regjistruar si “_____” dhe se nuk ka asnjë individ tjetër me këtë identitet, korrigjimi i të dhënave personale të ankueses në Amzë nuk është kryer, në kundërshtim me nenin 13 dhe 19 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të marrë masa për të kryer bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, në rastet kur konstaton se të dhënat rreth subjektit të të dhënave (ankueses në rastin konkret) nuk janë të rregullta, të

vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këto kushte, Kontrolluesi duhet të plotësonte dokumentacionin shkollor përkatës konform kompetencave ligjore, duke pasqyruar të dhënat e ankueses në mënyrë të saktë, sikurse rezultojnë në aktet e gjendjes civile, lidhur me mbiemrin dhe atësinë.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në datë 03.02.2025, me prezencën e përfaqësueseve të Kontrolluesit, si dhe përfaqësues të Zyrës Vendore Arsimore Tiranë (ZVA Tiranë), ku shprehën dakordësinë në lidhje me konstatimet e gjetura.

Gjithashtu, përfaqësuesja e ZVA Tiranë, ka depozituar shkresën nr. 968 prot., datë 05.02.2025, ku ndër të tjera citon se: “...Baza ligjore të cilës i referohet ZVA Tiranë në raste të ngjashme si këto, është neni 32/c i Kodit të Procedurës Civile”.

Neni 32/c i K.Pr.C parashikon se: “*Padia mund të ngrihet: c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin*”.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit sqaron se pretendimi i mësipërm nuk qëndron, për shkak se jemi para faktit se është konstatuar një gabim material, i cili konsiston në pasqyrimin e pasaktë të të dhënave personale të subjektit të të dhënave (ankueses).

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk duhet të anashkalohen apo të mos konsiderohen si prova provuese aktet bazë të lindjes, sikurse është certifikata personale dhe vërtetimi i gjeneraliteteve lëshuar nga organi i vetëm kompetent siç është Zyra e Gjendjes Civile.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë të dhëna personale të subjekteve të të dhënave duke respektuar parimin e ligjshmërisë së përpunimit dhe në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, ku konkretisht në nenin 5, pika 1, germa “ç”, parashikohet se: “*Mbrojtja/përpunimi i të dhënave personale bazohet ndër të tjera, në saktësinë që të dhënat duhet të kenë, dhe kur është e nevojshme, duhet të përditësohen; duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej*”.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 19, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32 të Ligjit,

U R D H Ë R O J :

1. Kontrolluesi, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, korrigjimin e të dhënave në dokumentin shkollor “Vërtetim” në Rubrikën “atësi/mbiemër” në “ ”.
2. Kontrolluesi, të informojë subjektin e të dhënave personale, për korrigjimin e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 30 ditëve.

Afati i sipërpërmendur, fillon nga data e marrjes në dijeni të këtij akti.

4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky Urdhër u shpall sot më datë 14.02.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi